



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË**

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE
Nr. 1850 prot. Pukë më, 03 10, 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Date _____ / 10/ 2024.

**PËR
“EMERTIM RRUGE, NË TERRITORIN E BASHKISË PUKË”**

Në mbështetje të:

- Nenit 8 pika 2, neni 9 nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ll”, nenit 55 pika 2 e 6 të ligjit nr.139/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar),
- Nenit 2 pika 1(q), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25 e 26, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 ”për sistemin e adresave” (i ndryshuar),
- Ligjit nr. 107/2014 ”Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar),
- Si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës _____/10/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës pranë sheshit qendror ”Gjergj Kastrioti - Skenderbeu”, në drejtim të stacionit të autobuseve, me emrin rruga ”Ndoc Mark Deda”, sipas planvendosjes bashkëlidhur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Pukë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 ”Për vetëqeverisjen Vendore”

Hartuesi

Drejtoria e Plan. të territorit
Ing.Lindita Hyseni

Juristi
Aida Sinani

KRYETARI
RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

**MBI PROJEKT VENDIMIN PËR “EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË
PUKË”**

PËR KËSHILLIN BASHKIAK
Pukë me 10.07.2024

Të nderuar këshilltarë !

Ky projekt vendim është hartuar në mbështetje të:

- Nenit 8 pika 2, neni 9 nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ll”, nenit 55 pika 2 e 6 të ligjit nr.139/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar),
- Nenit 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25 e 26, të ligjt nr. 9270, datë 29.07.2004 “për sistemin e adresave” (i ndryshuar),
- Ligjt nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar),

Kryetari dhe Administrata e bashkisë propozon që këshilli i Bashkisë Pukë të emërtojë rrugën pranë sheshit qendror “Gjergj Kastrioti - Skenderbeu”, deri në stacionin e autobuseve, me emrin **Ruga “Ndoc Mark Deda”**, sipas planvendosjes bashkëlidhur

E bëjmë këtë propozim për emertim rruge në kuadër të ruajtjes së simboleve dhe të vlerave të figurave tona Kombëtare të cilët sakrifikuani jetën e tyre në shërbim të Atdheut. Një prej këtyre figurave është edhe **Dëshmor i Atdheut Ndoc Mark DEDA (1880-1915)** (Statusi i Dëshmorit Nr.640 datë 08.04.2013), me një aktivitet të gjerë atdhetare duke filluar nga viti 1910 ku bashkë me çetën e tij, çau rrithimin e pushtuesve në Belshinë-Berishë, Pukë.

Në vitin 1911 në krye të çetës së tij (e quajtura, çeta e Ndoc Mark Dedës) kreu luftime të ashpra ndaj pushtuesit, në viset veriore si: Lezhë, Shkoder, Mirditë, Pukë, etj.

Në vitin 1912, mori pjesë në të gjitha luftimet që nga lufta e Midhës e deri në zmbrapsjen e garnizonet osman në Pukë e ngritjen e falmurit dhe Shpalljen e Pavarësi në Vlorë.

Në vitin 1913, në krye të çetës së tij kreu luftime të ashpra duke dalë fitimtarë ndaj pushtuesit Sero-Malazez në rrithinat e Shkodrës, kryesish në zonat Drisht dhe Vrakë.

Në vitin 1915, duke ju përgjigjur thirrjes së **Ded Gjon Lulit e Mehmet Shpendit** për ndihmë,

Sero-Malazez në rrethinat e Shkodrës, kryesisht në zonat Drisht dhe Vrakë.

Në vitin 1915, duke ju përgjigjur thirrjes së **Ded Gjon Lulit e Mehmet Shpendit** për ndihmë, gjatë luftimeve me pushtuesit Sero-Malazez në malësi të Shkodrës ndërron jetë nga plagët e marra.

Bashkëngjitur harta imazh satelitor i rrugës,

Segmeti rrugore që Propozohet: **Nga "Sheshi Shkenderbej – Stacioni i autobusave", Pukë.**

Pra: Gjurma e propozuar fillon tek «pika-1» dhe mbaron tek «pika-2» sipas hartës- imazhit satelitore bashkangjitur.

Historiku:

JETA E NDOC MARK DEDËS KALENDAR TRIMËRIE

Kur atdhetarizmi shëndërrohet në stafetë frymëzimi për brezat

Nga: Servet AGALLIU, Sekretar i Përgjithëshem i Komitetit Kombëtar të Organizatës të Veteranëve të LANÇ (NDERI I KOMBIT), Gazeta "Kushtrim Brezash", dt. 22.10.2021, F.1.9.

Patrioti i Mirënjohnur Ndoc Mark Deda u lindë në vitin 1880 në fashatin Berishë të rrethit Pukë. Ritej e kalitej si për tu përgaditur vetem për luftë kundër pushtuesve të huaj. Dëshmitar të kohës e patën dëgjuar tek sa u pat thënë: "Kurr nuk do ti dorzoj amët e mia !"

Me 5 Dhjetor 1910 u zhvillua epopeja e lavdishme e qëndresës Kombëtare ndaj ushtrisë së madhe të Shefqet Turgut Pashës i cili kishte ardhur në viset e Pukës dhe me forcë kërkonte zbatimin e ligjeve të qeverisë Xhon Turke, por Ndoci si prijës i trimave të këtyre anëve nuk pranoi çarmatosjen, detyrimin ushtarak, etj. Ai me vëllezërit e tij dhe babë Markun u rrethuan në befasi, në shtëpinë e tyre në Berishë nga forcat e shumta ushtarake të armatosur deri në fyt, pas luftimesh të ashpra Ndoci me vëllezërit e tij çan rrethimin dhe i smbrapsen zaptit, por nga këto luftime ata u plagosën të tre, kurse i ati i tyre, Mark Deda ra dëshmor, i parë i Atdheut në treven e Pukës, ky prijës e pjesmarrës në betejat legjendare të Lidhjes së Prizrenit në mbrojtjen e Plavës e Gucisë dhe Fushë Kosovës, burri i urtë në momentet e fundit të jetës u tha djemve të tij: "Ecni, luftoni e jetoni, lamtumirë!", ndërsa nga ana e pushtuesve pati me dhjetra të vrarë mes të cilëve edhe Çaushti, si dhe të plagosur të shumtë. Kjo qëndresë heroike është përjetësuar në histori përmes këngës së Ndoc Mark Dedës e botuar në gazeta, libra, revista, buletine, tek "Visaret e Kombit ", Tiranë 1939, f.87-88, tek "Visaret e Kombit", Tiranë 1944, f.159-160, si dhe nga "Akademia e Shkencave" të Republikës së Shqipërisë (A.SH.R.SH), "Epika Historike", në vitin 1981, f.605-606, etj., si dhe është mbledhur dhe botuar në disa variante të saj nga studjuesi i mirënjohnur Pukajn Xhemal Meçi (Mjeshtër i Madh) tek libri "Poeti i Malësisë", " Puka që në lashtësi" - 5, Tiranë 2013, f.57-74, plot 16-variante, duke shprehur faktin se është kënga më e përhaur.

Në prill 1911, Ndoc Mark Deda me çetën e tij së bashku me trimat e tjerë malësorë, ishin në përkrahje të Torenc Toçit në udhëtimin nga Toplana, Berisha në Iballë për në Fanë, Mirditë, ku u

shpall "Qeveria e Përkoħshme Shqiptare". Në gusht 1911, Ndoci më çetën e tij së bashku me trimat e tjerë Pukjanë, Mirditorë, Lezhjanë, etj., merr në mbrojtje Kryeministrin e "Qeverisë së Përkoħshme Shqiptare", Torenc Toçin, në mbledhjen që bëhej në Shëngjin të Lezhës, e cila kishte për qëllim organizimin e një kryengritje anti Osmane.

Në kuadër të "Besēlidhjes së Pukës" ose siç njihet ndryshe "Besēlidhja e 7-Bajrakëve të Pukës", me datën 28 qershor 1912 së bashku me rrëth 400 malësorë të viseve të tjera të Pukës morën pjesë me trimëri në betejën e Lajthizës ku për humbjet e pësuara, forcat osmane në shenjë hakmarrje, organizuan operacione ndëshkimore duke djegur kullën e Halil Musës, Hasan Nezirit në Kabash e duke dëmtuar arat me misër, veprime të cilat vetëm sa e rritën urrejtjen populllore. Me datën 22 korrik 1912 forcat e shumta osmane nisën mësymjen në zonat e panënshtuara si: Berisha, Midha, Iballa, Bugjoni etj., ku ishte dhe krahu kryesor i kryengritjes, kështu me dhjetra malësore zunë Qafën e Tmugut për të filluar një betejë treditore që në histori do të njihej me emrin "Lufta e Midhës", e cila përbën një epope të lavdishme të popullit Pukjan përliri e pavarësi Kombëtare. Në ditën e parë dhe të dytë forcat osmane kishin bërë përparime të mëdha dhe në zonat ku kalonin u vinin zjarrin shtëpive. Por krerët e kryengritësve u jepnin zemër djelménisë së Midhës, se janë rrugës Djelmënia e Berishës dhe e Thaçit. Në mbrëmjen e ditës së dytë mbërriti Ndoci Mark Deda me djelméninë e çetës së tij, ata ia kalonin një ushtria të vërtetë për nga sulmi dhe guximi në luftë. Në natën e tretë me 25 korrik 1912 djelmënia e maleve të Pukës u bë një forcë e madhe, erdhën Berisha, Iballa, Bugjoni e mbarë brigjet, Qerreti, Ukthi, etj., në këto kushte ushtria osmane, filloj tërheqjen duke djegur çdo gjë që i dilte përpara. Më 1912 Ndoci merr pjesë në gjitha luftimet në çlirimin e largimin e forcave osmane prej Puke dhe së bashku me vëllezërit: Gjergjin e Mëhillin shoqëroi delegatët e Kosovës, me prijës Isa Boletinin për në Vlorë ku dhe u shpall Pavarsia e Shqipërisë.

Gjatë rrithimit të Shkodrës prej ushtrive pushtuese Serbo-Malazeze, Ndoci me çetën e tij së bashku me shumë dukagjinës zbritën poshtë Shllakut dhe sulmuan forcat armike. Nga këto sulme siguruan shumë armë dhe municione që i merrnin prej ushtarëve të vrarë. Ai, në prill 1913 bashkë me çetën e tij dhe luftëtarë Dukagjinës dhe të Pultit të Shkodrës, kreu sulme të tjera të suksesshme në zonën e Drishtit dhe të Vrakës së Shkodrës kundër pushtuesve Malazezë që luftonin për pushtimin e Shkodrës.

Ndoci me çetën e tij, në prill 1915, i përgjigjet kërkësës së Ded Gjon Lulit e Mehmet Shpendit për të marrë pjesë në qëndresën heroike të Dukagjinës së Shkodrës ndaj pushtuesve Serbo-Malazezë. Gjatë luftimeve të përgjakshme në Mollë të Shoshit të Shkodrës, ra dëshmor vëllai i tij Mëhill Mark Deda, si dhe plagoset rëndë Ndoci i cili ndërrroi jetë pas tre muajve në shtëpi, korrik 1915, por mbetet i paharuar në kujtesën e popullit tonë si një luftëtar i lavdishëm i Kombit Shqiptar.

Gjurmët e këtij trimi të paepur, mbetën të freskëta e të pashlyera në mbarë trevat shqiptare, atij kudo i këndohet kënga me lahute, çifteli, maje krahut, nga kostarët e fushave, argatët e shatit, çetat e komitave, udhëtarët e dasmorët, ninullat e nënëve, etj, për të cilët shërben si motivim në veprimtarinë e tyre. Në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare qëndresa, trimëria dhe veprimitaria e tij

atdhetare u bënë burim frysëzimi për qëndresën ndaj hordhive shoviniste, madje në shumë këngë thirrej Ndoc Mark Gega, duke e simbolizuar si tribun e hero lirie të të gjithë Gegnisë. Figura e lavdishme e Ndoc Mark Dedës ishte shndërruar në një legjendë sa që nënët ju këndonin në djep fëmijëve të tyre, ku ja si e përshkruan poeti i mirënjohur Kombëtar, fitues i disa çmimeve kombëtare e ndërkombëtare Ton Zmali në librin e tij "Honeve të Askundi", f. 49:

Mi ngjafshë dhëndërr Skenderbeut,

Nuse Marrësh të bukuren e dheut...

Ditë të bardha pruftë për tyjeta,

Namin paç si Ndoc Mark Deda.

Me dekret Nr.6680 datë 17 Nëtor 1982, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, "Ndoc Mark Dedës" i është dhënë medalja "Për veprimitari Patriotike", me motivacionin: "Për ndihmën e dhënë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në pjesëmarrjen në luftën për liri, pavarësi, e çlirim Kombëtar dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale të trojeve Shqiptare".

Me vendim Nr. 640, datë 08 Prill 2013, Ndoc Mark Deda është shpallur "Dëshmor i Atdheut", dhe familjes së tij i jep simbolin "Familje e Dëshmorit të Atdheut".

Me Vendimin nr.137 datë 05.10.2021, të Këshillit Bashkiak Tiranë, Bashkia Tiranë ka miratuar emërtimin e një rruge në Tiranë, në njësinë Administrative nr.11, Laprakë, me emrin: "Ndoc Mark DEDA".

Në vitet "60, të shekullit të XX, nipi i Ndoc Mark Dedës, Prendushi djali i Gjergjit, katin e dytë të kësaj kulle legjendare të historisë së kombit tonë e bëri shkollë publike për të gjithë zonën e Brebullave të Berishës, në një kohë kur lufta kundër analfabetizimit ishte një prioritet kombëtar dhe në këtë mënyrë kjo kullë historike u shndërrua, në një kullë simbol të "Paqes, Dijes dhe Lirisë", kaq shumë të dëshiruar për një popull si ky i yni, i cili është i lashtë sa vetë lashtësia në këto troje.

Bëj babë të të ngjajë thotë populli. Brez pas brezi atdhetarët guximtar mbeten po ata: Të zgjuar dhe trima. Në ditët e sotëme ka bërë emër nipi i Ndoc Mark Dedës: Kol Deda i shpallur "Qytetar nderi i Pukës".

Është mirë kur atdhetarizmi shëndërrohet në stafetë frysëzimi për brezat.


Të nderuar Këshilltarë !

Nga sa më lart është në vlerësimin tuaj të miratoni emërtimin e kësaj rruge "Ndoc Mark Deda", si nderim dhe lartësim i **modeleve më të mira**

Konspektoi: ing. L. Hyseni



Hartografia: Planvendosja e Rruges



Rruja Ndoc Mark Deda: Fillon ne "**Pika-1** ne kryqezim me Rrugën 'X'" dhe Mbaron ne "**Piken-2** kryqezm me Rrugën-Unaza"